Amendments to the Labor Code have created a new perspective on employer-employee relations. Both parties have rights and obligations, which must be implemented rigorously. HR departments play an essential role in the smooth development and consolidation of these relations.

At the meeting, AmCham members and Ms. Skëndaj exchanged experiences on various HR issues that had escalated to legal proceedings in court. The way HR staff and departments handle these issues plays a direct role on the outcome of the court cases. Ms. Skëndaj gave advice on how HR specialists need to be careful when establishing an employment relation, keeping a written track record, exchanging information via email and getting signatures on all appropriate documents, following the proper protocol.

An employee's file must contain everything needed to measure performance - the individual's development plan, work performance assessments, promotions, and other remarks, thus, creating a clear record of employment.

Speaking about how supervisors can use disciplinary measures in compliance with the Labor Code, Ms. Skëndaj explained to AmCham members that fines on employees are not allowed, and that supervisors can issue a warning and escalate the issue step by step when facing issues with employees. This would help both sides get a fair judgement should the issue end up in court at a later date.




The frequency of national holidays, taking time off, overtime payments and term contracts were among other issues discussed at the meeting.



# DITËT E HR-IT

# BOGA & ASSOCIATES NDAN EKSPERIENCËN E SAJ ME ANËTARËT E AMCHAM-IT




Ditët e HR-it janë rikthyer sërish në Dhomën Amerikane me tema dhe sfida të reja për departamentet e HR-it.

Ka qenë Boga & Associates e cila mbështetur në çështjet që vijnë nga Kodi i Punës si dhe siguria dhe shëndeti në punë, ka ndarë eksperiencat e tyre me anëtarët e AmCham-it.
Kodi i Punës dhe impakti i tij në marrëdhëniet punëdhënës - punëmarrës, është tema e preferuar e ekspertëve në departamentin e HR-it. Anëtarët e Dhomës Amerikane i kanë trajtuar edhe njëherë çështjet më të nxehta që hasen në një raport pune me eksperten e Boga & Associates, Jonida Skëndaj, e cila ka dhënë ekspertizën e saj për shumë nga sfidat me të cilat përballen punonjësit e HR-it.

**ZGJIDHJA E MARRËDHËNIEVE TË PUNËS, MASAT DISIPLINORE, PAGAT NË NATYRË, ORGANIZIMI I LEJEVE TË ZAKONSHME E DERI TEK ZGJIDHJET NË GJYKATA, KANË QENË ÇËSHTJET E TRAJTUARA GJATË 'HR OPEN FORUM DAYS' NË ZYRAT E BOGA & ASSOCIATES.**

Ndryshimet në Kodin e Punës kanë krijuar një perspektivë të re në marrëdhëniet punëdhënës – punëmarrës, të cilët kanë përballë një manual të të drejtave dhe detyrimeve që duhet zbatuar me rigorozitet. Janë departamentet e HR-it ato që luajnë një rol thelbësor në zhvillimin normal të këtyre marrëdhënieve dhe në konsolidimin e tyre.

Por gjatë zhvillimit të veprimtarisë, dalin probleme për të cilat anëtarët prezentë në takim kanë marrë orientimin dhe mendimin e specializuar të znj. Skëndaj, e cila i është referuar jo vetëm praktikave më të mira, por edhe Kodit të Punës.

Gjatë takimit, anëtarët e Dhomës dhe znj. Skëndaj kanë shkëmbyer eksperiencat e tyre për çështje të ndryshme që i dalin HR-it dhe që janë dërguar në gjykatë. Mënyra se si i përqasen problemit punonjësit e departamenteve të HR-it ka të bëjë shumë me gjykimin e çështjeve në gjykatë. Znj. Skëndaj ka dhënë këshillat e saj për mënyrën se si specialistët e HR-it duhet të jenë të kujdesshëm kur ndërtojnë një marrëdhënie pune, për të mbajtur në dosje çdo shënim, shkëmbim informacioni me e-mail dhe për të protokolluar gjithçka.

Dosja e një punonjësi duhet të ketë gjithçka për performancën e tij, që nga plani i zhvillimit të individit, vlerësimet që i janë bërë gjatë punës, ngritjen në detyrë apo vërejtjet, duke përbërë kështu një histori të pasur me dokumentacion të punës së tij.

Duke folur për mënyrën se si eprorët përdorin masa disiplinore mbështetur në Kodin e Punës, znj. Skëndaj ka sqaruar anëtarët e AmCham-it se me Kod Pune është e ndaluar gjoba dhe eprorët duhet të përdorin masën e paralajmërimit dhe të përshkallëzimit për të gjitha rastet që vënë re tek punonjësit e tyre. Kjo do t'i përballte të dyja palët në gjykatë dhe do të ndihmonte për një gjykim të drejtë nga ana e gjykatësit.

Gjatë takimit është folur edhe për frekuencën e marrjes së ditëve të pushimit zyrtar, pagesat jashtë orarit, apo zgjidhjet e kontratës me afat.



## HR OPEN FORUM DAYS

# TELEKOM ALBANIA TALKS ABOUT HEALTH AND SAFETY AT WORK



Telekom Albania welcomed AmCham members to a gathering in Tirana's downtown Blloku neighborhood, to share their experience in establishing a highly safe workplace, which guarantees workers' health and wellbeing. Health and Safety (HSE) at work is regarded as a priority by Telekom, a brand that operates in many European countries and which is highly experienced in this.

During its introduction, Telekom focused on HSE elements at work and the certification of all indicators that establish a friendly and healthy environment for employees.



**VALUING EMPLOYEES AS THE COMPANY'S STRONGEST ASSET, TELEKOM IS INVESTING A LOT IN ESTABLISHING THE RIGHT WORKING CONDITIONS THAT GUARANTEE THE OPTIMIZATION OF EMPLOYEES' PRODUCTIVITY.**

Telekom experts introduced the Safety Management System Certification they have obtained, placing working standards at best European levels. The whole process starts with the identification of the working positions status, to continue with a thorough analysis and the improvement and monitoring of safety at work.

A safety conditions management process involves not only all employees, but also all stakeholders, suppliers and customers. Work starts with the definition of criteria for a safe workplace and the identification of all possible threats.

There are five steps in creating a safe and healthy environment at work, which encompass the determination of the workplace, precautionary measures, analysis of every workplace, improvement and monitoring.

Those are the stages that managers go through to determine every workplace and to have a general environment meeting all safety and health at work criteria.

Thanks to the provided work standards, Telekom Albania has been awarded all the required quality certifications from ISO 9001, CHSAS 18001 to ISO 14001.

## DITËT E HR-IT

# TELEKOM ALBANIA FLET PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË

Telekom Albania ka mirëpritur anëtarët e AmCham-it në zyrat e tyre në zonën e Bllokut, për të ndarë me ta eksperiencat e krijimit të një ambienti pune me kushte të larta sigurie dhe garantimin e shëndetit të punonjësve. Kjo çështje shikohet si një prioritet në Telekom Albania, i cili është një brand që funksionon në shumë vende të Europës dhe ka një eksperiencë të gjerë në këtë fushë.
Gjatë prezantimit të vet, Telekom Albania është përqendruar në elementët e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe certifikimit të të gjithë treguesve që krijojnë një ambient miqësor dhe të shëndetshëm për punonjësit.

**DUKE I KONSIDERUAR PUNONJËSIT SI ASETI MË I FORTË I NJË KOMPANIE, TELEKOM ALBANIA PO INVESTON SHUMË NË KRIJIMIN E KUSHTEVE TË PUNËS QË SIGUROJNË OPTIMIZIMIN E PRODUKTIVITETIT TË PUNONJËSVE.**

Ekspertët e Telekom, kanë prezantuar Certifikatat e Menaxhimit të Sistemeve të Sigurisë që kanë marrë dhe që vendosin standardin në punë në nivele bashkëkohore europiane. I gjithë procesi fillon si një evidentim i situatës së pozicioneve të punës, për të vazhduar me një analizë të hollësishme dhe më pas me përmirësimin dhe kontrollin e situatës së sigurisë në punë.



Në një proces të menaxhimit të kushteve të sigurisë marrin pjesë jo vetëm punonjësit, por të gjithë stakeholders, furnizuesit dhe klientët. Puna fillon me përcaktimin e kritereve për një vend pune të sigurtë dhe identifikimin e të gjithë kërcënimeve të mundshme.

Janë pesë hapat për të krijuar një ambient të sigurtë dhe të shëndetshëm në punë. Nga përcaktimi i pozicionit të punës, tek masat që merren, analizat për çdo vend pune e deri tek përmirësimi dhe kontrolli. Në këto etapa kalojnë menaxherët për të përcaktuar kushtet e çdo vendi pune dhe për të patur një ambient të përgjithshëm brenda gjithë kritereve të sigurisë dhe të shëndetit më punë.

Telekom Albania është e pajisur falë standardit që ofron në punë me të gjitha licensat e nevojshme të cilësisë nga ISO 9001, CHSAS 18001 e deri tek ISO 14001.



# HR OPEN FORUM DAYS

# DM CONSULTING SPEAKS TO AMCHAM MEMBERS ON ROBOTICS AND THE FUTURE OF ARTIFICIAL INTELLIGENCE IN BUSINESS

Technology and business walk hand in hand, and the future belongs to technology. The sooner businesses understand and embrace this approach, the more secure their place in the market will be. This was the foundation of the discussion between Mr. Dritan Mezini of DM Consulting and the members of AmCham.



Mr. Mezini shared his expertise as information technology expert on the use of technology and its advantages.

**DUAPUNE.COM, WHICH HE MANAGES, RELIES HEAVILY ON INFORMATION TECHNOLOGY TO DEVELOP THE EMPLOYMENT MARKET AND TO EXTEND ITS INFLUENCE ACROSS THE COUNTRY AND BEYOND.**

Meanwhile, Albania is not moving at the same pace as the technological developments in the world. "We speak different languages when it comes to technological developments and it can be said that we have "non-communication" protocols with developed countries, for now," stated Mr. Mezini.

Silicon Valley offers another virtual reality, where the word 'technology' has surpassed human imagination. Words like 'robotics', artificial intelligence, etc., have become a normality, while we should rush to adapt to the developments. Mankind should face the reality. The theory that the development of artificial intelligence will bring about job cuts causes fear and mankind should realize that there is no need for fear. For every technological development that requires the intervention of robots, new jobs controlled by people will be generated.

During his presentation, Mr. Mezini encouraged the attending AmCham members to start thinking about educating their employees on technological developments, as the only way to be competitive in the future.

Technological developments are emerging from the market, creating new leading companies and "leaving behind" the old ones, and it seems that topping the list of the most profitable companies today are technology and IT-based companies.





# DITËT E HR-IT

# DM CONSULTING FLET ME ANËTARËT PËR ROBOTIKËN DHE TË ARDHMEN E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË BIZNES

Teknologjia dhe biznesi qëndrojnë bashkë dhe e ardhmja i takon teknologjisë. Sa më shpejt bizneset ta kuptojnë dhe ta përqafojnë këtë përqasje, aq më të sigurtë do ta kenë vendin e tyre në treg. Ka qenë ky motivi i diskutimit mes z. Dritan Mezini nga DM Consulting & Services dhe anëtarëve të Dhomës Amerikane.

Z. Mezini ka sjellë eksperiencën e tij si informaticien në përdorimin e teknologjisë dhe avantazheve të saj.



**'DUAPUNE.COM' MBËSHTETET PIKËRISHT TEK TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT PËR TË ZHVILLUAR TREGUN E PUNËSIMIT DHE PËR TË SHTRIRË INFLUENCËN E SAJ NË TË GJITHË VENDIN DHE PËRTEJ.**

Por ndërkaq, duket se Shqipëria nuk ecën me të njëjtin hap për sa i takon zhvillimeve teknologjike në botë. Ne flasim gjuhë të ndryshme kur vjen fjala për zhvillimet teknologjike dhe mund të thuhet se kemi protokolle moskomunikimi me vendet e zhvilluara, u shpreh z. Mezini.

Eksperiencat në Silicon Valley të përballin me një tjetër realitet pothuajse virtual, ku fjala e teknologjisë e ka tejkaluar imagjinatën njerëzore. Fjalët robotikë, inteligjencë artificiale, etj. janë kthyer në një normalitet me të cilin duhet të nxitojmë të adaptohemi.

Teoria se zhvillimi i inteligjencave artificiale do të sjellë shkurtime të vendeve të punës, është një frikë me të cilën njerëzimi duhet të përballet dhe të kuptojë se nuk ekziston. Për çdo zhvillim të teknologjisë që kërkon ndërhyrjen e robotëve, do të kërkohet të hapen fronte të reja pune që kontrollohen nga njerëzit.

Gjatë prezantimit të tij, z. Mezini i ka kërkuar anëtarëve të AmCham-it prezentë në takim, të fillojnë të mendojnë për të edukuar punonjësit e tyre me zhvillimet teknologjike, si e vetmja formë për të qenë konkurrues në të ardhmen. Zhvillimet në teknologji po nxjerrin nga tregu kompani lider dhe po krijojnë të rinj, dhe duket se ata që janë në top listën e kompanive më fitimprurëse sot janë kompanitë e mbështetura në teknologji dhe IT.



# CHAMBERS OF COMMERCE

## COME TOGETHER AT WINE TASTING EVENT











Foreign Chambers of Commerce based in Tirana came together at an event to introduce the business community to the variety and quality of Albanian wines. The wine tasting event aimed to establish a network among these chambers, but also introducing an ever growing winemaking and wine tasting industry.

Each country has its own winemaking tradition and specifics. Even though it has an early winemaking tradition, Albania still doesn't have a sophisticated and developed wine industry and is trying hard to catch up with renowned international brands. Albania's trading partners, represented in the country through their chambers of commerce, are ready to share that experience.

The French, German, Austrian and American chambers of commerce as well as the International Chamber of Commerce came together to establish a small wine tasting market of each country. Fancy food products accompanied the best wines of each country and guests had the opportunity to tour stands and get to know them first-hand.

A band playing live music and performing tunes from each country made the evening even more interesting. Greeting all guests, the hosting City Park director said such cooperation represents the best each country has to offer, increases cooperation among chambers of commerce and helps set up joint dynamics.

The American Chamber of Commerce in Albania was represented in this event with its own stand of American wines which were valued for their quality and taste. The American wines were showcased through the AmCham stand by Vila Ferdinand.

# DHOMAT E TREGTISË
## BASHKOHEN TEK 'WINE TASTING'

Dhomat e Huaja të Tregtisë në Tiranë janë bashkuar në një takim për t'i prezantuar komunitetit të biznesit larminë dhe cilësinë e verërave të vendit që përfaqësojnë. 'Wine Testing' ka patur për qëllim të krijojë një network mes këtyre Dhomave, por dhe të prezantojë një industri gjithnjë e në zhvillim të prodhimit dhe shitjes së verës.

Çdo vend ka traditën dhe specifikat e veta në prodhimin e verës. Shqipëria, edhe pse me një traditë të vjetër, nuk ka një industri të sofistikuar dhe të zhvilluar të verës dhe po përpiqet shumë që të ecë me hapin e emrave të njour në tregun ndërkombëtar. Ndërkohë, partnerët e saj tregtarë, të cilët përfaqësohen në Shqipëri nëpërmjet Dhomave të tyre të Tregtisë, janë të gatshëm të ndajnë këtë eksperiencë.

Dhomat e Tregtisë të Francës, Gjermanisë, Austrisë, Dhoma e Amerikane e Tregtisë, Dhoma Ndëkombëtare e Tregtisë, janë bashkuar për të krijuar një treg të vogël të degustimit të verës së çdo vendi. Produkte fancy ushqimore, kanë shoqëruar prodhimet më të mira të verës së çdo vendi dhe të ftuarit patën mundësinë të shëtisnin në stenda dhe të njiheshin nga afër me to.

Mbrëmja u bë edhe më interesante nga muzika life, e cila solli pak nga shijet muzikore të çdo vendi, duke e bërë kështu mbrëmjen edhe më të këndshme. Duke përshëndetur të gjithë të pranishmit, Drejtorja e Tirana Business Park, u shpreh se bashkëpunime të tilla jo vetëm janë përfaqësuese për vendet, por dhe rrisin bashkëpunimin mes Dhomave të Tregtisë dhe ndihmojnë për të patur dinamika të përbashkëta.

Dhoma Ameriakne e Tregtisë u përfaqësua në këtë event me stendën e saj të verërave amerikane, të cilat patën mjaft sukses për cilësinë dhe shijen e tyre. Verat amerikane u prezantuan përmes stendës së Dhomës Amerikane nga Vila Ferdinand.



# MEMBER NEWS

On the verge of the 20th anniversary of its establishment, SIGAL UNIQA brought to Albania 120 business leaders from all over Europe. The largest insurer in Albania and the region, SIGAL UNIQA Group Austria, organized as part of its 20th Albania anniversary the first International Forum on the Insurance Industry in Albania, bringing together more than 120 CEOs and heads of boards of directors from the UNIQA Insurance Group companies in 16 European countries.

The forum was preceded by a media conference held at the premises of the Protocol Hall of the Prime Minister's Office with the participation of Albania's Deputy Prime Minister, Ms. Senida Mesi, the CEO of UNIQA Insurance Group, Mr. Andreas Brandstetter, the CEO of SIGAL UNIQA for Albania, Kosovo and Macedonia, Mr. Avni Ponari, the State Minister for Entrepreneurship, Ms. Sonila Qato, the Deputy Finance and Economy Minister, Mr. Elton Haxhi, Deputy Foreign Affairs Minister, Ms. Kleopatra Maliqi, the deputy head of Albania's Financial Supervisory Authority, Ms. Mimoza Kaçi, ministers and other government representatives, representatives of financial institutions and diplomats in Albania, including the Ambassador of Austria to Albania, Mr. Johann Sattler and others.

In his speech, the CEO of UNIQA Insurance Group, Mr. Brandstetter, said the European financial group he leads chose to invest in Albania through SIGAL eleven years ago because the Albanian market has extraordinary potential to grow and develop. He added he was convinced that it has been one of the best decisions he made in business and that he had not regretted at all. Mr. Brandstetter said that the investment and interest of the giant Austrian insurer UNIQA will continue in Albania and that cooperation with SIGAL and its head, Mr. Avni Ponari, has been excellent, correct and fruitful.

The Director General of the SIGAL UNIQA Group Austria, Mr. Ponari said the presence of a strategic investor such as UNIQA Group is a very good investment and serves as a guarantee for the domestic insurance market, boosting its service standards and the variety of products offered to consumers.

The focus of the meeting with the media, business and government representatives were the novelties SIGAL UNIQA brings to citizens through digitization and innovation.

SIGAL UNIQA is the first company in Albania to have introduced online insurance sales. Today, it trades eight online insurance products, including vehicle and home insurance, enabling customers to have faster access to the services and products they need, at no extra cost and without the need to go to physical stores. Home insurance has a key impact on households, enabling them to benefit immediate compensation by the company in cases of floods or fires and eliminating bureaucracy with state institutions to seek help in such cases.

# LAJME ANETARESH

Në prag të 20-vjetorit të themelimit të saj, SIGAL UNIQA sjell në Shqipëri mbi 120 drejtues biznesesh nga e gjithë Europa. Kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, SIGAL UNIQA Group Austria, në kuadër të 20-vjetorit të themelimit të saj në Shqipëri, organizon të parin Forum Ndërkombëtar të Industrisë së Sigurimeve në Shqipëri, me pjesëmarrjen e mbi 120 CEO-ve dhe Kryetarëve të Bordeve Drejtuese të kompanive UNIQA Insurance Group nga 16 shtete Europiane.

Forumi u paraprі nga një konferencë për mediat e zhvilluar në ambientet e Hollit Protokollar në Kryeministri, ku merrnin pjesë zëvendëskryeministrja e Shqipërisë znj. Senida Mesi, z. Andreas Brandstetter, CEO i UNIQA Insurance Group, z. Avni Ponari, CEO i SIGAL UNIQA për Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë, Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, znj. Sonila Qato, zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë, z. Elton Haxhi, zëvendësministrja e Punëve të Jashtme, znj. Kleopatra Maliqi, nënkryetarja e AMF-së, znj. Mimoza Kaçi, ministra dhe përfaqësues të tjerë të qeverisë, përfaqësues të institucioneve financiare dhe diplomatike në Shqipëri, Ambasadori i Austrisë në Shqipëri, z. Johann Sattler etj.

Në fjalën e tij, CEO-ja i UNIQA Insurance Group, z. Brandstetter tha se grupi europian financiar që ai drejton zgjodhi të investojë në Shqipëri 11 vite më parë nëpërmjet SIGAL, sepse tregu ynë ka një potencial të jashtëzakonshëm për t'u rritur dhe zhvilluar dhe nënvizoi se ky ka qenë një nga vendimet më të mira që ai ka marrë në biznes dhe se nuk është penduar për këtë.

Z. Brandstetter tha se investimi dhe interesi i gjigandit austriak të sigurimeve, UNIQA do të vazhdojë në Shqipëri dhe se bashkëpunimi me SIGAL dhe drejtuesin z. Avni Ponari është një bashkëpunim i shkëlqyer, korrekt dhe shumë i frytshëm.

Ndërsa vetë Drejtori i Përgjithshëm i kompanisë SIGAL UNIQA Group Austria, z. Avni Ponari tha se futja e investitorit strategjik në Shqipëri, UNIQA Group, është një investim dhe garanci shumë e mirë për tregun vendas të sigurimeve, i cili rrit standardet e shërbimit dhe produkteve që u ofrohen qytetarëve.

Boshti i takimit me mediat dhe përfaqësuesit e biznesit dhe të qeverisë sot ishte risia që kompania SIGAL UNIQA sjell për qytetarët nëpërmjet dixhitalizimit dhe inovacionit.

SIGAL UNIQA është e para kompani në Shqipëri që futi shitjen on-line të sigurimeve. Sot ajo numëron 8 produkte sigurimesh on-line, ndër të cilat edhe sigurimi i automjeteve dhe shtëpisë, dhe klientët mund të marrin shërbimin dhe produktet që u nevojiten shumë shpejt, pa kosto shtesë dhe pa patur nevojë të shkojnë nëpër zyra. Veçanërisht sigurimi i shtëpisë ka një impakt të rëndësishëm tek qytetarët, kjo sepse me sigurimin e shtëpisë çdo qytetar nuk ngelet pas dyerve të institucioneve për të kërkuar ndihmë kur i përmbytet apo digjet shtëpia, por dëmshpërblehet menjëherë nga kompania e sigurimit.

# Invitation

**Dear Member of AmCham,**

The Economic and Commercial Office of the U.S. Embassy in Tirana, invites representatives from both public and private sector that operate in the solar power business to attend the Solar Power International Trade Show that takes place from September 24-27, in Anaheim, California, USA.
We would highly appreciate if you would consider attending the event. If yes, please fill in the attached form and send it toUSAL-Buisiness@state.gov BEFORE August 15, 2018.
For more information on the show please visit **https://www.solarpowerinternational.com/**

**SPI Overview**

SPI is the largest solar show in North America; It is expected to attract over 650 exhibitors and over 20,000 attendees from more than 100 countries. Focused on providing the latest updates and information for the solar energy industry, SPI features multi-track conference sessions and a large curriculum of conference workshops including business & market trends, solar+storage, utility & grid integration, just to name a few.

**Product Categories:**

Manufacturing Equipment, Meter, Performance Monitoring, PV Cell, PV Material, PV Module, Racking System, Solar Thermal Collector, Tracker, Operations & Maintenance, Energy Storage, EPC Contractor, Government, Investor/Financier, Manufacturer – Battery, Manufacturer (Building Integrated PV, Concentrating PV, Consumer PV Products, CSP Components, Inverter, Operations & Maintenance - Panel Washing, PV Distributor, PV Installer/Contractor, Real Estate Developer, Smart Home Technology, Solar Hot Water Distributor, Solar Hot Water Installer/Contractor, Utility, Vertically Integrated Solar Company, Academic, Architect/Builder, Business Services, etc..
List of Companies Exhibiting in the show: Please visit the following link for a full list of exhibiting companies registered up to now https://spi18.mapyourshow.com/7_0/alphalist.cfm?alpha=*

Energy Storage International (ESI): ESI, the largest energy storage exhibition in North America, with over 150+ exhibiting companies, will be co-located with SPI 2018. As energy storage increases the power of solar by storing and releasing energy on-demand where it is needed on the grid, both utilities and energy providers can take advantage of increased revenue and customer satisfaction.
Hydrogen + Fuel Cells North America: Hydrogen + Fuel Cell (H2+FC) North America will also be co-located with SPI 2018. H2FC exhibitors profit from several synergy effects between the solar and energy storage industry. The topics of H2+FC North America will be hydrogen generation, storage and transportation, fuel cell systems and applications, stationary, automotive, mobile fuel cells, components and supplying technology, and fuel cell and battery testing.
Smart Energy Micro-grid Marketplace: Home, building automation, and smart energy technologies are natural compliments to the solar industry, as automation technologies focus on using energy more productively. Everything comes together at SPI in The Smart Energy Microgrid Marketplace. In 2018, the marketplace will include the entire solar, storage, hydrogen fuel cells, and smart energy microgrid landscape. The marketplace features a fully-functioning "live" microgrid, power conversion equipment, energy management systems, building and home smart energy products, electric vehicle charging stations, energy storage systems, and solar energy products—ultimately making the connection between solar, storage, hydrogen fuel cells, and smart energy.

**Potential attendees:**

Manufacturers; Government officials with responsibilities in solar; Installers/Contractors; Construction/EPC Contractor; Project Developers; Solar Integrator; Financial/Legal Firms ; Consulting Services; Solar Suppliers; Distributors; Business Services; Utility; Nonprofit; IPP (Independent Power Producers)

**Service our office offers:**

- Complimentary (free) exhibit hall visitor pass (valued at $175/day or $375 for three days) - Exhibit pass provides entry to SPI exhibit floor and co-located events (workshops are a separate fee), expo hall sessions, use of International Business Center, IBP reception and other exhibitor receptions on the show floor.
- Reduced SPI Conference package at: $830 (valued at $1,230.) Discounted SPI rate provides access to education sessions, exhibit hall, welcoming networking reception and block party event.
- Meetings with U.S. exhibitors - Meetings arranged in collaboration with Department of Commerce team working in the show.
- List of exhibitors who indicate an interest in exporting to the region.
- Complimentary use of the International Business Center, relaxing lounge area with large round tables for B2B meetings with U.S. exhibitors, refreshments, and interpreter assistance if needed
- Dedicated IBP Registration Badge-Pick up area.

Please do not hesitate to reach out to our office if you have any questions.
Looking forward to your participation in this show.

**Best regards, Edi Jaçellari**

Edi Jaçellari | Commercial Assistant | Political and Economic Section |United States Embassy Tirana|
Phone. (+355) (4) 229 3116 | Mobile +(355) 68 208 0367 | E-mail: jacellarie@state.gov

# Ftesë

**I nderuar anëtar i Dhomës Amerikane,**

Zyra Ekonomike dhe Tregtare në Ambasadën Amerikane në Tiranë, fton perfaqësuesit e sektorit publik dhe privat që operojnë në sektorin e energjisë diellore të marrin pjesë në panairin "Solar Power International Trade" që do te zhvillohet në data 24-27 Shtator, ne Anaheim, Kaliforni, SHBA.
Do t'a vlerësonim shumë nëse konsideroni pjesëmarrjen në këtë event. Ne rast se po, plotesoni formularin bashkengjitur dhe dergojeni ne adresen e e-mailit USALBusiness@state.gov PERPARA dates 15 gusht 2018. Per me shume informacion vizitoni adresen e internetit: **https://www.solarpowerinternational.com/**

## Përshkrim i SPI:

SPI është panairi më i madh i energjisë diellore në Amerikën e Veriut; pritet që të tërheqë rreth 650 kompani pjesëmarrëse dhe rreth 20,000 pjesëmarrës nga më shumë se 100 shtete. Eshtë i fokusuar në shpërndarjen e përditësimeve dhe informacioneve të fundit rreth industrisë së energjisë diellore, SPI përmban sesione të konferencave multi-track dhe një kurrikulum të madh të konferencave duke përfshirë trendet e biznesit dhe të tregut, ruajtjen diellore, integritetin e shërbimeve dhe rrjetit, etj. janë vetëm disa nga shërbimet e këtij panairi.

## Kategoritë e produktit:

Prodhuesi (BIM), Prodhues (Ndërtim i Integruar, Prodhues, Mbikëqyrje të Performancës, PV Fabrika, PV Fabrika, PV Module, Sistemi i Racking, Collector Solar Termike, Tracker, Veprimet dhe Mirëmbajtja, PV, Concentrating PV, Consumer PV Products, Komponentët CSP, Inverter, Operacionet & Mirëmbajtja - Panel Washing, PV Distributor, PV Installer / Kontraktor, Real Estate Developer, Smart Home Technology, Kompani qe kane te integruar vertikalisht energjine diellore, akademikë, arkitektë / ndërtues, shërbimet e biznesit, etj.
Lista e kompanive Ekspozuar në shfaqje: Ju lutemi vizitoni linkun e mëposhtëm për një listë të plotë të kompanive ekspozuese të regjistruara deri më tani: https://spi18.mapyourshow.com/7_0/alphalist.cfm?alpha=*

Energy Storage International (ESI):
ESI, ekspozita më e madhe e magazinimit të energjisë në Amerikën e Veriut, me mbi 150 kompani ekspozuese, do të bashkë-vendoset me SPI 2018. Pasi ruajtja e energjisë rrit fuqinë e diellit duke ruajtur dhe lëshuar energji aty ku është e nevojshme në rrjet, të dy shërbimet dhe ofruesit e energjisë mund të përfitojnë nga rritja e të ardhurave dhe kënaqësia e konsumatorëve.
Hidrocentrali + Karburantet Amerika e Veriut:
Hidrogjeni + Karburantet (H2 + FC) në Amerikën e Veriut gjithashtu do të bashkë-vendosen me SPI 2018. Ekspozuesit H2FC përfitojnë nga disa efekte sinergjie midis industrisë së diellit dhe magazinimit të energjisë. Temat e H2 + FC në Amerikën e Veriut do të jenë gjenerimi, magazinimi dhe transporti i hidrogjenit, sistemet dhe aplikacionet e qelizave të karburantit, qelizat e karburantit të palëvizshëm, qelizat e karburantit, komponentët dhe teknologjia e furnizimit, dhe testimi i qelizave të karburantit dhe i baterive.
Tregu i Mikro-rrjetit të Energjisë Smart:
Automatizimi i ndërtesave dhe teknologjitë e energjisë smart janë plotësues natyrore për industrinë diellore, pasi teknologjitë e automatizimit fokusohen në përdorimin më energjik të energjisë. Çdo gjë vjen së bashku në SPI në The Smart Energy Microgrid Marketplace. Në 2018, tregu do të përfshijë të gjithë ruajtjen diellore, magazinimin, qelizat e karburantit me hidrogjen, dhe peizazhin microgrid të energjisë smart. Tregu përmban një mikrogrid "të gjallë", të plotë, funksionale dhe pajisje për konvertimin e energjisë, sisteme të menaxhimit të energjisë, ndërtimin dhe produkte energjie smart në shtëpi, stacione të ngarkimit të automjeteve elektrike, sisteme të magazinimit të energjisë dhe produkte të energjisë diellore – pra arritjen e lidhjes mes energjisë diellore, qelizave të karburantit me hidrogjen dhe energjisë smart.

## Pjesëmarrësit potencialë:

Prodhuesit; Zyrtarë, qeveritarë me përgjegjësi në fushën e energjisë diellore; instaluesit / kontraktorët; Ndërtuesit/ Kontraktet EPC; Zhvilluesit e Projekteve; Integratorët diellorë; Kompani Financiare / Juridike; Shërbimet e konsulencës; Furnizuesit diellorë; Shpërndarësit; Shërbimet e Biznesit; Organizata jofitimprurëse; IPP (Prodhuesit e Pavarur të Energjisë)

## Shërbimi që ofron zyra jonë:

• Pranimi i vizitorëve në sallë (pa pagesë) të sallës së ekspozitës (me vlerë $ 175 / day ose $ 375 për tre ditë) - hyrjen në katin e ekspozitës SPI dhe eventet e bashkëlidhura (trajnimet kanë një tarifë të veçantë), seancat në sallën së ekspozitës, Qendra e Biznesit, pritje IBP dhe pritje të tjera ekspozuese në hollin e panairit.
Paketa e reduktuar e Konferencës SPI : $ 830 (vlerësuar në $ 1,230) Norma e zbritur SPI siguron hyrje në seancat e edukative, sallat e ekspozitës, takim networking mireprites dhe festa e eventit.
• Takime me ekspozuesit e SHBA-së - Takimet e organizuara në bashkëpunim me Departamentin e Tregtisë që punojnë per kete panair.
• Lista e ekspozuesve të cilët tregojnë interes për eksport në rajon.
• Përdorimi falas i Qendrës Ndërkombëtare të Biznesit, hapësira relaksuese me tryeza të rrumbullakëta për takime B2B me ekspozuesit e SHBA, pije freskuese dhe ndihmë për përkthyes nëse është e nevojshme
• Zona e dedikuar e regjistrimit IBP-Pick-up.
Ju lutemi mos hezitoni te na kontaktoni per cdo rast.
Mirepresim pjesemarrjen tuaj.

**Me respekt, Edi Jacellari.**

Edi Jaçellari | Commercial Assistant | Political and Economic Section | United States Embassy Tirana| Phone. (+355) (4) 229 3116 | Mobile +(355) 68 208 0367 | E-mail: jacellarie@state.gov

abi

AMERICAN BANK
OF INVESTMENTS

*investo në optimizëm*

www.abi.al